



Pranimi / Dorezimi Bashkimi / Protokol Access / Delivery	29-03	2022	2	viti god year
Organ / Objekti Organ / Subject Org / Obj	SKAMBHEK	1661/2022		
Numri i Prokurimit Proc. No				
Titulli i Prokurimit Appelants				
Sasia Kolicina Quantity				113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.136/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtar, si dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.136/2022 të datës 16.02.2022 të parashtruar nga ankuesi Berat Jashari përmes përfaqësuesit të autorizuar

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, çështjen juridike “*kërkesa nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON procedimi administrativ** i iniciuar me ankesën me numër A.nr.136/2022 të datës 16.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas Akt emërimit të datë 06.12.2012, në pozitën „Zyrtar i lartë për Politika të Sigurisë”, në Departamentin për BE dhe NATO, me datë 15.07.2019 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nxjerr Vendim me numër Nr.ref.334/2019, sipas të cilit vendim ankuesi me gradë diplomatike Sekretar i Dytë, caktohet të shërbejë në Organizatën Ndërkombëtare: Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (Centre for security Cooperation) RACVIAC, me seli në Rakitje-Zagreb, Republika e Kroacisë, nga data 01.10.2019.

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 17.01.2022 nxjerrë Vendim me numër Nr. Ref.16/2022, sipas të cilit ankuesin me gradën Sekretar i Dytë në Organizatën Ndërkombëtare: Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (Centre for security Cooperation) RACVIAC e kthen/tërheq nga misioni diplomatik nga data 28.02.2022.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr. Ref.16/2022, të datës 17.01.2022 lidhur me tërheqjen dhe kthimin



e tij nga misioni diplomatik gjegjësisht nga Organizata Ndërkombëtare: Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (Centre for security Cooperation) RACVIAC, me datën 16.02.2022 përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 806/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 18.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje ne ankesën e ankuesit tek Ministria e Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 25.02.2022, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë

Divizionit për Burime Njerëzore njofton Këshillin se me datë 24.02.2022 Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nxjerrë Vendim me numër ref.90/2022, me të cilin vendim ankuesit me gradën Sekretar i Dytë në Organizatën Ndërkombëtare: Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (Centre for security Cooperation) RACVIAC i vazhdohet mandati në misionin diplomatik deri me datë 31.03.2022, si dhe e shfuqizon Vendimin me numër ref.16/2022 të datës 17.01.2022.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit: 806/2022; Vendimin nr.Ref.16/2022 të datës 17.01.2022 të Zëvendëskryeminstres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Autorizimi i datë 15.02.2022 nga përfaqësuesi i autorizuar; Akt emërimi i datës 06.12.2012; Vendimi Nr. ref.334/2019 i datës 15.07.2019; E-maili i datës 14.02.2022; Përgjigje në ankesë e datës 25.02.2022 me nr. protokollit 992/2022 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me shkresat e bashkangjitura, Vendimin me numër ref.90/2022 i datës 24.02.2022 të Zëvendëskryeminstres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit **është bërë i pamundur, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 16.02.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 806/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Zëvendës Kryeminstres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr. Ref.16/2022, të datës 17.01.2022 lidhur me tërheqjen dhe kthimin e tij nga misioni diplomatik gjegjësisht nga Organizata Ndërkombëtare: Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (Centre for security Cooperation) RACVIAC.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore, më datë 25.02.2022 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se me datë 24.02.2022 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nxjerrë Vendim me numër ref. 90/2022, me të cilin vendim ankuesit me gradën Sekretar i Dytë në Organizatën Ndërkombëtare: Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (Centre for security Cooperation) RACVIAC i është vazhduar mandati në misionin diplomatik deri me datë 31.03.2022, si dhe është shfuqizuar Vendimi me numër ref.16/2022 i datës 17.01.2022i Zëvendës Kryeminstres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me tërheqjen dhe kthimin e ankuesit nga misioni diplomatik.





Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ankuesit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër ref.90/2022 të datës 24.02.2022 nga Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i është vazhduar mandati në misionin diplomatik deri me datë 31.03.2022, si dhe me këtë vendim është shfuqizuar edhe Vendimi me numër ref.16/2022 i datës 17.01.2022 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me tërheqjen dhe kthimin e ankuesit nga misioni diplomatik, i cili ka qene edhe pretendim i ankuesit, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast pretendimi i ankuesit është përmbushur apo realizuar, dhe mbi këtë bazë nuk ka me objekt shqyrtimi gjegjesisht objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 i cili thekson se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**, andaj ne rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me anksën e datës 16.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

Bazuar në rrethanat si me lart, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.136/2022.**

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Ministrin të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

